

Predikimi i ofruar nga Peshkopi Heinrich Bedford-Strohm

Të dashur vëllezër dhe motra në Krishtin,

Hir dhe paqe për ju nga Zoti ynë Jezu Krisht, i cili është “Ringjallja dhe Jeta”. Mblidhemi sot me pikëllim dhe njëkohësisht me mirënjohje të thellë, teksa ia besojmë shpirtin e Fortlumturisë së Tij Kryepeshkopit të Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë, Anastasios, për qafimit të përjetshëm të Zotit tonë të ringjallur.

Në ditët e tij të fundit ne mund të ndjenim se sa shumë e donin këtu në Shqipëri, në vendin e shërbimit të tij të gjatë dhe të palodhur për njerëzit që atij i kishin hyrë në zemër. Dëgjuam se ai ishte bërë një udhëheqës kishtar shpirtëror dhe integrues jashtëzakonisht i rëndësishëm në të gjithë komunitetin ortodoks. Më lejoni t'i shtoj kësaj edhe zërin e lëvizjes ekumenike globale.

Për ne Kryepeshkopi Anastasios ishte një autoritet i madh shpirtëror: një teolog mbresëlënës, i rrënjosur thellë në traditën e tij dhe në të njëjtën kohë me një horizont jashtëzakonisht të gjerë. Ai ishte një vëlla i dashur në Krishtin, i dashur nga të gjithë për përlësinë, dashamirësinë dhe dashurinë e tij. Ai ishte një nga figurat ortodokse më me ndikim në lëvizjen ekumenike për dekada, një figurë madhështore, kontributet e të cilit në Këshillin Botëror të Kishave (WCC) i dhanë formë misionit të tij dhe zgjeruan vizionin e tij. Ai shërbeu si një teolog vizionar dhe një udhëheqës pragmatik, për shembull në zyrën e tij si President i WCC (për të përmendur një nga shërbimet e shumta), duke kontribuar thellësisht në misionin e WCC për të bashkuar kishat në mirëkuptim të ndërsjellë dhe dëshmi të përbashkët. Shkrimet e tij të gjera teologjike trajtuan çështje kritike, si misioni i Kishës në një botë pluraliste, dialogu ndërfeetar, kujdestaria mjedisore, teologjia e pajtimit, drejtësia sociale dhe roli i Kishës në trajtimin e pabarazisë ekonomike globale. Këto vepra mbeten një burim i fuqishëm frymëzimi, duke i inkurajuar të krishterët në mbarë botën të kapërcejnë ndarjet, të nxisin

mirëkuptimin e ndërsjellë dhe të jenë një shenjë uniteti në këtë botë të ndarë.

Kryepeshkopi Anastasios priti takime dhe konsultime ndërkombëtare ekumenike, duke ofruar platforma për dialog dhe reflektim të përbashkët për çështje të ngutshme globale. Ai tregoi gjithashtu përkushtim të palëkundur për fuqizimin e të rinjve dhe avancimin e rolit të grave në Kishë.

Teologjia e tij ishte thellësisht e rrënjosur në marrëdhëniet. Ai ilustron ekumenizmin e zemrës që është një burim i tillë shtytës për përkushtimin tonë në lëvizjen ekumenike, duke nxitur marrëdhëniet ndërmjet besimeve dhe traditave të besimit. Kuptimi i tij i unitetit ishte i rrënjosur thellë në vizionin Trinitar të Zotit si një bashkësi dashurie, një bashkësi që thërret Kishën ta pasqyrojë këtë unitet në jetën dhe misionin e saj.

Kryepeshkopi Anastasios na kujtoi se ekumenizmi nuk është një veprimtari periferike, por qendrore për misionin dhe thirrjen e Kishës. Krishti nuk është i ndarë; si mund të ndahemi ne si popull i Krishtit? Prandaj, ndërsa nderojmë kujtimin e tij, le ta përqafojmë rishtas detyrën ekumenike me guxim dhe vendosmëri, duke marrë frymëzim nga jeta që ai bëri me aq besnikëri. Ai personifikoi moton e asamblesë së fundit të WCC në 2022: "Dashuria e Krishtit e shtyn botën drejt pajtimit dhe bashkimit." Le të vazhdojmë misionin e tij duke thelluar vëllazërinë tonë si të krishterë dhe duke u solidarizuar me të gjithë njerëzit vullnetmirë.

Zoti i dha bekime të shumta jetës së Kryepeshkopit Anastasios e po aq të shumta ishin bekimet që erdhën nga jeta e tij për kaq shumë njerëz. Ne si WCC kemi marrë një pjesë të bollshme të saj. E lavdërojmë Zotin për jetën e tij. Ne e kthejmë atë në krahët e Zotit me mirënjohje të madhe. Ne besojmë se ai tani hyn në mbretërinë e Perëndisë, ku nuk ka më vuajtje, ku të gjithë lotët janë fshirë dhe ku nuk ka asgjë tjetër përveç paqes.

Amen.